



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:258232
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05591921

PAKR.nr.525/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B., nga fshati, Komuna e Deçanit, për shkak të veprave penale, vrasje e mbetur në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPK, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.54/2022, të dt.16.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.20.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si r pabazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, kurse aktgjykimi i të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.54/2022, të dt.16.06.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.54/2022, të dt.16.06.2023, është shpallur fajtor i akuzuari B.B., për shkak të veprave penale, vrasje në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPK, dhe i është shqiptuar,

-për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, dënimi me burgimi, në kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve, në të cilin dënim, i është llogaritur koha e kaluar ne paraburgim nga dt.12.11.2021, gjerë me dt.28.02.2023, dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak, nga dt.28.02.2023, gjerë me dt.04.04.2023.

Pjesa tjetër e dënimit të shqiptuar me burgim, do të mbahet prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, dhe

-për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim me gjobë në shumën prej 1.000 (njëmijë) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për një ditë burgimi 20 Euro të gjobës.

I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, në shumë prej 450 (katërqind e pesëdhjetë) Euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është obliguar i akuzuari që ta paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari F.H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civilo - juridik.

Të akuzuarit i është konfiskuar, një pistoletë e llojit “CZ 99”, me nr. serik:126518, kalibër 9x19mm, me 1 (një) karikator dhe 6 (gjashtë) copë fishekë.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.479/2023, të datës 07.09.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.54/2022, i dt.16.06.2023, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.20.03.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit ka prezantuar i akuzuari B.B., dhe mbrojtësi i tij, av.Blerim Ademaj, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av.Ndrec Dodaj, edhe pse ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar, kurse sa i përket aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase nuk është gjetur motivi i kryerjes së veprës penale, e po ashtu nuk është administruar si provë CD-ja, e cila gjendet në shkresat e lëndës.

I akuzuari B.B., deklaron se e mbështet në tërësi ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit të tij, Av.Blerim Ademaj, si dhe paraqitjen e tij në seancë të kolegjit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, nuk është e bazuar

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.2 pika 1.10 lidhur me par.2, pika 2.1, 2.5,2.6 dhe 2.7 të KPPK. Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit aktgjykimi përfshihet me shkelje esenciale që kanë rezultuar me shkeljet e dispozitës ligjore, nga neni 369 i KPPK, ngase i njëjti nuk është përpiluar konformë dispozitës përkatëse, ngase nuk ka dhënë arsye të qarta për çdo pikë të aktgjykimit. Nga dispozitivi i aktgjykimit, i cili nuk është i qartë, nuk është në harmoni me vetveten, si dhe me arsyet e dhëna, rezulton se motivi i kryerjes së kësaj vepre penale, është sepse në rrugën “Luan Haradinaj”, në Deçan, me dt.12.11.2021, rreth orës 15:15minuta, përballë stacionit policor në Deçan, i akuzuari me dashje dhe armë tenton ta privoj nga jeta të dëmtuarin F.H., pasi që kishte ndodhur një mosmarrëveshje ditën kritike, në shkollën fillore “Heronjt e Dukagjinit” në Glllogjan, ndërmjet fëmijëve të dy familjeve. Me këtë rezulton se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vërtetuar motivin e kryerjes së veprës penale, kurse në faqen 17 të aktgjykimit, jep arsye të tjera, lidhur me rastin e ndodhur, që nënkupton se i njëjti nuk përputhet sikurse kërkon dispozita ligjore. Nga të gjitha të vlerësuarat rezulton se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 361 par.2 të KPK, ngase nuk ka vlerësuar me ndërgjegje të plotë të gjitha provat në këtë çështje penale, për të vërtetuar faktet konkrete për ekzistimin e veprave penale. Po ashtu edhe saktësia e provave nuk është e qartë, e po ashtu gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë ndonjë arsye se për çfarë nuk janë aprovuar propozimet konkrete të folura, si dhe arsyet në të cilat është bazuar zgjedhja e çështjes juridike.

Gjithashtu, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, rezulton se nuk është në përputhje të plotë deklarimi i të akuzuarit me video incizimet nga kamerat në vendin e ngjarjes, e po ashtu nuk përputhjet edhe me akt ekspertimin mjeko - ligjor të plotësuar të dt.27.03.2021, ashtu që këto shkelje të aktgjykimit të njëjtin e bëjnë të pa qartë dhe të pa kuptueshëm.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sikurse pretendon mbrojtësi i të

akuzuarit B.B., av.Blerim Ademaj, të cilat shkelje janë të parapara në nenin 384 të KPPK, dhe për të cilat përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK. Gjithashtu ka vlerësuar aktgjykimin së bashku me të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i të njëjtit është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, si dhe me pjesë të tjera të aktgjykimit, ngase përmban arsyet vendimtare lidhur me faktet të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit B.B., janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, të vrasjes në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPK, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK. Që të gjitha veprimet procedurale të cilat janë ndërmarrë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka qar në drejtim të çështjes, për të vërtetuar çdo veprim të akuzuarit, për ekzistimin e veprave penale, ashtu që janë zbatuar dispozitat përkatëse ligjore, e sidomos lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 1.10 të KPK, sepse ka dhënë arsyetim lidhur me të gjitha provat në çështjen penale, sikurse janë provat personale po ashtu edhe ato materiale. Po ashtu nga aktgjykimi rezulton se të gjitha propozimet e ngritura në çështje penale, kanë qenë të bazuara, mirëpo edhe arsyet e dhëna nga ana gjykatës së shkallës së parë kanë qenë të qarta dhe të sakta, ashtu që kanë pasur përputhshmëri me të gjitha veprimet e tjera, e sidomos edhe me vërtetimin e gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar të gjitha dispozitat ligjore, ka respektuar rrjedhën e procedurës, duke i proceduar të gjitha provat, sikurse personale edhe ato materiale, duke vepruar brenda kompetencës ligjore, e po ashtu i njëjti është përpiluar edhe në pajtim me dispozitën ligjore nga neni 369 të KPPK. Nga kjo vërtetohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është punuar konformë dispozitës përkatëse ligjore, duke përmbajtur formën e kërkuar me shkrim, ngase përmban të gjitha pjesët që duhet ti ketë aktgjykimi. Në hyrje të aktgjykimit janë përfshirë elementet të cilat kërkojnë sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, ku është bërë përshkrimi faktik i veprave penale, të cilat i vihen në barrë të akuzuarit, e po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme, se pse është nxjerr aktgjykim dënues, duke sqaruar se veprat penale për të cilat shpallet fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse ligjore, janë pasqyruar në aktgjykim. Nga të gjitha këto edhe arsyet të cilat janë dhënë, janë konformë dispozitave përkatëse ligjore, sepse gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar çdo pikë të aktgjykimit, duke dhënë arsye të posaçme dhe ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte janë vërtetuar, se cila ka qenë saktësia e provave në këtë çështje penale, duke vërtetuar motivin e kryerjes së veprës penale, si dhe elementet ikriminuese të veprave penale, andaj si i tillë aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Edhe për shkak të vërtetimit të gabuat dhe jo të plotë të gjendjes faktike, është ankimuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar se i mbrojturi i mbrojtësit, është shpallur fajtor për shkak të veprave penale, të cilat nuk i ka kryer andaj si i tillë aktgjykimi është i pa qëndrueshëm. Se aktgjykimi është marrë në kundërshtim me provat nga shkresat e lëndës, nga të cilat nuk mund të vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë, e aq më shumë edhe i njëjti bazohet në prova të pa pranueshme. Nisur nga deklaratat e dëshmitarëve L.T., e njëjta është në kundërshtim me deklaratat e dy dëshmitarëve tjerë, F. e F.H., të cilët kanë deklaruar se armën ia kemi kapur në dorë B., duke e bllokuar që të mos shtijë në drejtim të tyre, derisa ka ardhur policia dhe kanë intervenuar. Sa i përket deklaratës së dëshmitarit L.T., i njëjti deklaron se armën e kam pasur në dorë, dhe pasi që ka ardhur policia F.H., më ka thënë lësho armën në tokë, të cilën edhe e kam leshu. Të gjitha këto gjykata e shkallës së parë, ka

pasur mundësi që ti vërtetoj edhe nga CD, incizimet e kryera, mirëpo nuk i ka vlerësuar në masë të duhur për të ardhur deri te përfundimi se ditën kritike i akuzuari B.B., a ka shtënë në drejtim të dëmtuarit dhe ka pasur qëllim që të njëjtin ta privoj nga jeta, apo jo.

Kolegji kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të qartë dhe të plotë, ka vërtetuar gjendjen faktike, se ditën kritike, me dt.12.11.2021, rreth orës 15:15minuta, në rrugën “Luan Haradinaj”, në Deçan, përballë stacionit policor, i akuzuari me dashje dhe me armë ka tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin F.H. pasi që paraprakisht kishte një mosmarrëveshje. Mosmarrëveshja përndryshe ka ndodhur në shkollën fillore “Heronjtë e Dukagjinit”, në Gllogjan, në mes të fëmijëve, ndërsa këtu i dëmtuari me vëllaun e vet F., kanë shkuar në polici për të deklaruar rreth rastit, kurse i akuzuari pasi që paraprakisht është njoftuar me rastin, e merr armën dhe nis për në Deçan, duke pritur se kur po i del i dëmtuari, e pasi që del, atëherë e shfrytëzon momentin kur i dëmtuari e kthen shpinën dhe e godet me pistoletë të tipit “Cërvena Zastava -99”, të kal.9x19mm, dhe atë shtinë tri herë dhe me një plumb e godet të dëmtuarin në këmbën e majtë mbi gju, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, duke konstatuar më për së afërmi në raportin mjeko ligjor.

Nga kjo rezulton se i akuzuari ditën kritike, pasi që ka pasur një mosmarrëveshje në mes të fëmijëve, dhe paraprakisht pasi që e ka marrë armën, me të cilën edhe e ka goditur të dëmtuarin, e cila vërtetohet edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve, F.H., F.H., L.T. dhe F.H.1, nga të cilat deklarata rezulton se vepra penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, është kryer përkundër asaj që i akuzuari mundohet me çdo kusht që ti shmanget përgjegjësisë penale juridike, për kryerjen e së njëjtës.

Po ashtu edhe nga provat materiale nga shkresat e lëndës, sikurse është raporti i oficerit i dt.12.11.2021, raporti tjetër i oficerit i po të njëjtës datë, shënimi zyrtar i hetuesit, i po të njëjtës datë, shënimi tjetër zyrtar i hetuesit, i po të njëjtës datë, si dhe dëshmitë e tjera, sikurse janë ekspertiza mjekoligjore përkitazi me lëndimet trupore të marra, gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar që të gjitha dhe nga provat materiale dhe personale, e sidomos pas vlerësimit të deklaratës së të dëmtuarit dhe të dëshmitarëve, edhe CD, incizimi i marrë nga kamerat e pompës së derivateve “Shell”, në mënyrë të pa dyshimtë rezulton se i akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë, të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjyimit, duke vërtetuar se pasi që i dëmtuari paraprakisht është fjalosur me të akuzuarin dhe kur i dëmtuari nis në drejtim të veturës së tij, ia kthen shpinën të akuzuarit, i akuzuari i fut fishekun në tytë armës, por në atë qastë menjëherë i dëmtuari kthehet në drejtim të akuzuarit dhe i hedhet në duar, kurse i akuzuari vazhdimisht bënë përpjekje për ta ngritur dorën lartë, mirëpo pengohet nga i dëmtuari dhe ka shtënë me armën e tij, duke e goditur të njëjtin. Të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e të akuzuarit si dh të dëmtuarit, rezultojnë në bazë të incizimit të CD-ve, ashtu që gjykata e shkallës së parë, pasi që e ka administruar si provë CD, e incizimit, atëherë edhe ka vërtetuar se i dëmtuari ditën kritike ka pësuar lëndime trupore, nga shkrepa e armës, nga ana e të akuzuarit, që rezultojnë nga ekspertimi mjeko ligjor, me nr.0075502, të dt.19.01.2022, e plotësuar me dt.08.02.2023 dhe 27.03.2023, në të cilën janë përshkruar lëndimet duke u kualifikuar si lëndime të lehtë trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit dhe të shkaktuara me armë të zjarrit.

Nga raporti i ekspertimit rezulton se tri gëzhoja të gjetur në vend të ngjarjes janë shkrepur nga arma – pistoleta “Cërvena Zastava”, model, 99, që të gjitha gjykata i ka vërtetuar se tri gëzhoja janë shkrepur nga e njëjta armë, e më pastaj për nevoja të mëtutjeshme janë konfiskuar. Edhe nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, janë vërtetuar veprimet të cilat i ka ndërmarrë i akuzuari në drejtim të dëmtuarit, të cilat janë përputhur gjatë ndërmarrjes së veprimeve, me gjendjen faktike të vërtetuar se dhe ditën kritike është shtënë nga arma e lartë theksuar. E njëjta armë më pastaj është konfiskuar.

Pas vlerësimit të të gjitha provave sikurse atyre personale, po ashtu atyre materiale, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të njëjtën në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar, ashtu që pretendimet ankimore të mbrojtësit së të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Po ashtu mbrojtësi i të akuzuarit, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ankimon për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke pretenduar se vepra penale e vrasjes në tentativë, nuk karakterizohet me elementet të cilat janë përshkruar për këtë veprë penale, sepse i mungon figura e veprës penale, pastaj mungon dashja, qëllimi, motivi, e që të gjitha këto qojnë në drejtim të asaj se i akuzuari nuk ka pasur qëllim që me dashje të kryejnë veprën penale të vrasjes në tentativë, e aq më pakë që në këtë çështje penale nuk janë formuluar elementet qenësore të veprës penale për të cilën është akuzuar.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me shkeljet e ligjit penal, dhe ka ardhur në përfundim se pretendimet ankimore në këtë drejtim nuk janë të bazuara, sepse aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, të parapara në nenin 385 të KPPK. Kolegji ka vlerësuar se vepra penale e vrasjes në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPK, ekziston ngase janë formuluar elementet qenësore të së njëjtës dhe është vërtetuar se nga ana e të akuzuarit është kryer, sikurse që është kryer edhe vepra penale e mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPK. Pasi që në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor, kolegji ka ardhur në përfundim se nuk ka arsye që i akuzuari të përjashtohet nga ndjekja penale si dhe përgjegjësia penale, se është aplikuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, pasi që ka vendosur që i akuzuari është fajtor për veprën penale, të cilat i vihen në barrë dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Edhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, është ankimuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av. Blerim Ademaj, duke pretenduar se në këtë çështje penale i akuzuari është dashur që të lirohet nga akuza, sepse nuk ka prova se i njëjti ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj pasi që aktgjykimi përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, i njëjti duhet anuluar dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, apo që të vlerëson në mënyrë më përmbajtësore rrethanat lehtësuese, e sidomos që i akuzuari për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin dhe ka shfaq gatishmëri që të bashkëpunon me organet e drejtësisë.

Kolegji i kësaj gjykate, ka vlerësuar ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit, aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara në nenin 69 dhe 70 të KPK, kurse si rrethanë lehtësuese e ka pasur parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës. Po ashtu ka vlerësuar edhe të gjitha rrethanat përkitazi me veprën penale të vrasjes në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPK, dhe si rrethanë rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, pasi që i akuzuari e ka vendosur në brez armën dhe e ka pritur të dëmtuarin për më shumë se 30 minuta, para stacionit policor, derisa ka dalë i njëjti, e më pastaj ka shtënë në drejtim të tij. Gjithashtu mënyra e kryerjes së të njëjtës, e sidomos në prezencën e vajzës së të dëmtuarit, ka qenë moment i rëndë, të cilën rrethanë gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë e ka përshkruar dhe paraqitur në aktgjykim, andaj pasi që e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, nuk i ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.525/2023, të datës 20.03.2023

Bashkëpunëtori profesional,
Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Kadrije Goga Lubishtani